



Të drejat dhe detyrat e prindërve

Kush lind një fëmijë, duhet menjëherë ta lajmëroj lindjen në zyrën civile. Te çiftet e martuara është e drejta e përkatësis të fëmijut automatikisht e rregulluar, çiftet e pa martuara duhet për këtë vet të përkujdesen.

Lajmërimi i lindjes

Lindja e çdo fëmiju duhet të lajmërohet në zyrën civile rajonale kujdes: Se cila zyrë e gjendjes civile është përgjegjëse mvaret prej vendit të lindjes dhe jo prej vendbanimit të prindërve. Nëse lindja bëhet në një spital, i dërgon spitali dokumentet në zyrën e gjendjes civile përgjegjëse. Nëse lindja nuk bëhet në një spital (por p.sh. në shtëpi), duhet që lindja të lajmërohet vet brenda tri ditësh. Zyra e gjendjes civile përgjegjëse informon, cilat dokumente janë të nevojshme. Fëmijët e lindur në Zvicër nuk marrin automatikisht nënshtetësin Zvicerane.

Njohja e atësis

Kur çiftet e martura kanë një fëmijë, bashkëshorti njihet automatikisht si baba. Nëse bashkëshorti dyshon që është baba, mundet me gjyq ta inicioj vërtetimin e atësisë. Kur prindërit nuk janë të martuar, babi i fëmijës nuk regjistrohet automatikisht si baba. Ai mundet fëmijën ta pranoj para ose pas lindjes në komunën që banon te zyra e gjendjes civile (Kindesanererkennung | Reconnaissance d'enfant). Nëse babi nuk e pranon fëmijën e tij mundet nëna me gjyq të kërkoj pranimin e fëmijut e tij.

Përkujdesja prindërore

Prindërit kanë të drejta dhe detyrime, për mirëqenjen e fëmijëve (elterliche Sorge | Autorité parentale). Këtu përkojnë për shembull edukimi, apo përkujdesja financiare. Prindërit përfaqësojnë fëmijët e tyre me ligj deri ata të bëhen 18 vjeç. Nëse prindërit janë të martuar i kanë automatikisht të drejtat dhe detyrimet e njëjta përkundrejt fëmijut. Nëse nuk janë të martuar duhet babai më parë ta pranoj fëmijun. Pastaj munden prindërit ta bëjnë vullnetarisht një sqarim me shkrim për përkujdesjen prindërore të përbashkët. Këtë e bëjnë njeriu ose së bashku me pranimin e fëmijut te zyra e gjendjes civile rajonale apo më vonë te zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve (KESB|APEA) në gjyqin civil rajonal. Nëse prindërit e pa martuar nuk janë të një mendimi për të drejtën për përkujdesje ndaj fëmijut, vendosin zyrtarët për mbrojtjen e fëmijëve dhe të rriturve. Kush ka pyetje apo i nevojitet mbështetje, drejtohet në një qendër përkatëse për këshillim, këshillimore për edukim apo këshillimore për jetë bashkëshortore dhe familjare.



Përkujdesja materiale

Kur prindërit ndahen, janë ata edhe më tutje të detyruar, të përkujdesen për fëmijën (mbajtja, Unterhalt|Entretien). Ata duhet për këtë, ta rregullojnë gjendjen financiare, dhe përkujdesjen për fëmijë me njëri tjetrin. Pagesa për përkujdesje ndahet në mes babait dhe nënës. A, dhe sa njëri prind duhet të paguaj, mvaret prej situatës ekonomike dhe pjesëmarrjen e tij për përkujdesjen për fëmijun. Nëse nuk është e mundur një marrëveshje, mundet njeriu të shkojë para gjyqit. Nëse vie të ndarja apo shkurorëzimi me gjyq, atëherë shuma që duhet të paguhet rregullohet me gjyq. Nëse nuk paguan partneri i detyruar për këtë, mundet njeriu në komunën ku banon të kërkojë ndihmë (Inkassohilfe|aide au recouvrement). Kjo ndihmon, që shumën e caktuar ta kërkojë nga i detyruari dhe/apo cakton një shumë për pagesë, nëse njëri nga partnerët ka të drejtë për këtë (Alimentenbevorschussung|Avance des contributions d'entretien).

Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

www.hallo-bern.ch/sq/marredhenie-partneresh-dhe-femijet/te-drejat-dhe-detyrat-e-p-rinderve